



## FILLOI REALIZIMI I PROJEKTIT TË PËRBASHKËT MES GJAKOVËS DHE PARDUBICËS ÇEKE

**Brenda këtij viti, ekspert të qytetit Pardubica të Republikës së Çekisë do të ndihmojnë ekspertët gjakovarë për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të Gjakovës dhe përmirësimin e strategjive zhvillimore, u tha në përmbyllje të punimeve dy ditore të komisionit të përbashkët.**

"Ky është projekti i financuar nga Ministria e Jashtme dhe i përkrahur nga Ambasada e Republikës së Çekisë në Kosovë që ka nisur me iniciativën e Asociacionit të komunave çeke dhe kompanisë MEPCO në fushën e projekteve të Bashkimit Evropian (BE)," tha Michal Kolaček nënkryetar i komunës së Pardubicës i cili e vlerësojë punën dy ditore të ekspertëve të të dyja komunave në hulumtimin e nevojave më të ngutshme për një zhvillim të Gjakovës.

Gjakovës dhe Pardubicës përfshin zhvillimin ekonomik, grandet shtetërore dhe ato të BE\_së, programet sociale në arsim infrastrukturë, parandalimin e kriminalitetit marrëdhëniet me jashtë, menaxhim të resurseve humane e tjera.

"Komuna e Gjakovës është shumë mirënjohëse ndajë përfaqësuesve të komunës së Pardubicës dhe konsulentëve të MEPKO\_së, të cilët morën iniciativën dhe u angazhuan në realizimin e projektit të parë



Ai ka theksuar se gjatë takimeve dhe vizitave mjediseve të ndryshme në Gjakovë, kanë parë nga afër potencialet ekonomike dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet ekonomia.

"Gjatë punës sonë në vazhdimësi ne do të mundohemi të hartojmë një strategji që do të

ndërkombëtarë mes dy komunave, projekt ky që ka domethënie të madhe për qeverinë lokale, por edhe për Kosovën si shtet i ri i cili ka nevojë për mbështetje nga miq që vijnë nga radhët e BE-së, siç është Çekia", tha kryetari i komunës Pal Lekaj duke shprehur falënderime për homologun e tij në



## EKSPERTË NGA PARDUBICA

zgjidhë problemet e grumbulluara duke pasur parasysh potencialet ekzistuese dhe burimet njerëzore, dhe jemi të bindur se në këtë projekt do të përfshihen edhe komunat tjera çeke," tha Kolaček më optimist edhe pas takimit që kishte të martën në Prishtinë me Ambasadorin çeke në Prishtinë.

Ai ka shtuar se në ditët e ardhshme do të ketë edhe takime me disa nga ministrat e Qeverisë së Kosovës për të bashkërenduar

Pardubicë, Jaroslav Demi dhe ekspertët që ishin për dy ditë në Gjakovë,

Lekaj shtoi se "kjo nismë e përbashkët do të paraprijë bashkëpunimit më të ngushtë ndërkomunal dhe ndërshtetëror".

Pardubica njihet si një komunë e zhvilluar ekonomikisht dhe me një shkallë të papunësisë, ndër më të ulte në Republikë, prandaj gjakovarët kanë shpresa se nga ky bashkëpunim në të ardhmen do të përfitojnë